

PROCESVERBAL
nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 11.1.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshilli të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Sunçica Marinkova Sosieva nga RA Zora Dellçevë.

Z. Petrushevski hapi seancën e 2-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
2. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
3. Të ndryshme.

Z. Petrushevski informoi se në seancë nuk ka përfaqësues prezent nga SHTR RADIO ÇOKI 5 SHPKNJP Prilep, nëpërmjet lidhjes video-konferencë është paraqitur (njoftuar) Sunçica Marinkova Sosieva nga RA Zora Dellçevë. Ai ka sqaruar se seanca ka për qëllim arsyetimin e transmetuesit në lidhje me heqjen dorë nga veprimtaria. Në këtë drejtim, i dha mundësinë (fjalën) drejtueses së radios që t'i drejtohet Këshillit, drejtorit të Agjencisë dhe shërbimit në lidhje me vendimin e saj.

Sunçica Marinkova Sosieva nga RA Zora Dellçev, ju drejtua të pranishmëve dhe shpjegoi se do të mbyll radion para së gjithash për shkak të gjendjes financiare, sepse radioja këto dy vitet e fundit e ka pasur shumë të vështirë të ekzistoj. Ajo gjithashtu bëri të ditur se për arsye private do të transferohet dhe nuk do të mund të menaxhojë me radion.

Z. Petrushevski i dëshiroi sukse në jetën e saj të mëtutjeshme dhe shpjegoi se kohëve të fundit ka pasur më shumë radio lokale dhe televizione që kanë hequr dorë nga veprimtaria e tyre dhe i kanë mbyllur radiot. Ai e falenderoi për pjesëmarrjen dhe e mbylli seancën.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**